


GRAFIKU 1:

Statusi i punësimit të të diplomuarve sipas viteve (%)

2016 2017 2018



Shënim: Kategoria 'Tjetër' nuk është e përfshirë në grafik.

GRAFIKU 2:

Lidhja e arsimit me punën për të diplomuarit sipas viteve (%)

PO JO



VITI 2017

VITI 2018

TABELA 1:


Paga neto për të diplomuarit sipas viteve (%)

	2016	2017	2018
Më pak se 23,000 LEK	18	7	10
23,001 – 35,000 LEK	56	63	51
35,001 – 50,000 LEK	17	29	22
50,001 – 65,000 LEK	3	0	10
65,001 – 80,000 LEK	3	0	4
Më shumë se 80,001 LEK	3	2	3

GJURMIMI NË NIVEL OFRUESI

ÇFARË NËNKUPTON GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE?

- Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' të diplomuarit një vit pasi ata diplomohen/certifikohen.
- Tematikat e gjurmimit mund të jenë të shumëllojshme, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.



CILI ËSHTË KUADRI LIGJOR QË E MUNDËSON GJURMIMIN?

Gjurmimi në nivel kombëtar

Në përputhje me ligjin nr.15/2017 'Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë' Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është e ngarkuar me kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së (neni 9/2).

Gjurmimi në nivel ofruesi

Njësia e zhvillimit që do të ngrihet pranë ofruesve të AFP-së do të ketë si një nga funksionet e saj mbledhjen e të dhënave të gjurmimit në nivel ofruesi (neni 15).



CILA ËSHTË PËRVOJA E INSTITUCIONEVE TË MBËSHTETURA NGA 'AFTËSI PËR PUNË'?

Që prej shtatorit 2017, projekti 'Aftësi për punë' ka mbështetur pilotimin dhe ngritjen e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi në 7 institucione ofruese (5 rajone të Shqipërisë).



SHKOLLA
TEKNIKE ELEKTRIKE
GJERGJ CANCO

SHIP
SHKOLLA INDUSTRIALE PAVARËSIA



SHKOLLA
PROFESIONALE
KRISTO ISAK

DREJTORIA RAJONALE E
FORMIMIT PROFESIONAL
PUBLIK VLORE



KU NDRYSHON GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR NGA GJURMIMI NË NIVEL OFRUESI?



GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

- Informon ministrinë përgjegjëse dhe entitetet e tjera në nivel qendror mbi treguesit kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i AFP-së.
- Informon për zhvillimin dhe përmirësimin e politikave në nivel qendror.
- Ndihmon në analizën e mospërputhjeve të aftësive në nivel kombëtar.

GJURMIMI NË NIVEL OFRUESI

- Siguron monitorimin sistematik të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e institucionit.
- Ndihmon në marketingun institucional.
- Ndihmon në menaxhimin e planifikimit dhe monitorimit e ofertës të institucionit.
- Është fleksibël dhe çdo institucion mund ta përshtasë sipas nevojave të tij.
- Lehtëson proceset mbështetëse të orientimit dhe këshillimit në karrierë për nxënësit.
- Komplementon gjurmimin në nivel kombëtar.

KUSH?

Të gjithë të diplomuarit e një viti të një institucioni ofrues
→ **3 breza** të diplomuarish (2016, 2017, 2018)

KUR?

12
muaj pas diplomimit

SI?

Me **2** faza
përmes pyetësorëve të strukturuar

FAZA E PARA-GJURMIMIT

Aktivitetet ndërgjegjësuere mbi procesin

Plotësimi i anketës së para-gjurmimit me maturantët 1 muaj para diplomimit --> për të përditësuar databazën e kontakteve

ÇDO MAJ

05

FAZA E GJURMIMIT

Plotësimi i anketës së gjurmimit përmes pyetësorit online

Kontaktimi i vazhdueshëm i të diplomuarve --> për të siguruar një nivel të lartë të përgjigjeve

ÇDO QERSHOR

06



PËRDORIMI I TË DHËNAVE NË VAZHDIM

Do të dish më shumë rreth gjurmimit dhe sesi ai mund të zbatohet në nivel ofruesi?

Manuali për zbatimin e gjurmimit në nivel ofruesi (Dhjetor 2018, S4J)